

Luzern, 26. Juni 2024/VIR

Shkolla popullore e kantonit të Lucernit – nxitje për të gjithë

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë mund ta vizitojnë falas shkollën popullore të kantonit të Lucernit. Ata fitojnë shanse të barabarta për rrugën e tyre drejt profesionit. Shkolla popullore zgjatë sipas rregullit 10 deri 11 vjet. Ndjekja e shkollës është e detyrueshme, materialet mësimore janë falas. Shkolla i jep shumë rëndësi bashkëpunimit të mirë me prindërit.

Struktura 1.

| Kopështi | Cikli fillor | Shkolla sekondare |
|--|---------------------------|---|
| Kopështi 2 vjet 1 vit vizitim i detyrueshëm | Shkolla fillore 6 vjet | Shkolla sekondare 3 vjet Niveli A Niveli B Niveli C |
| Cikli bazë 3 – 5 vjet | | |

Hyrja në shkollë**Mosha dhe premiset**

Fëmijët, që mbushin 5 vjeç deri më 31 Korrik, është e detyrueshme të hyjnë në kopësht ose në ciklin bazë në gushtin paraardhës.

> Pindërit mund t'i dërgojnë fëmijët më të vegjël, në rast se ata i plotësojnë disa premisa: ata mundën ta bëjnë vetë rrugën e shkollës, t'i përmbahen orarit të shkollës dhe të vishen vetë.

> Në rast se një fëmijë nuk është akoma i aftë për shkollë, prindërit mundën, pas një bisede me drejtorinë e shkollës, ta shtyjnë hyrjen në shkollë maksimalisht me një vit.

Kopësht ose cikli bazë

Komunat ofrojnë ose kopështin dyvjeçar ose ciklin bazë. Cikli bazë përfshin dy vite të kopështit dhe dy vitet e parat të shkollës fillore. Klasat janë me mosha të përziera. Kjo do të thotë, se fëmijët më të vegjël dhe më të mëdhenj shkojnë në të njëjtën klasë dhe kanë gjatë katër viteve të njëjtit mësimdhënës. Fëmijët, të cilët mësojnë lehtë, mund ta përfundojnë ciklin bazë në tre vjet. Fëmijët, që kanë nevojë për më shumë kohë për të mësuar, mund të rrijnë 5 vjet në ciklin bazë.

Koha e mësimimit

Mësimi në kopësht dhe në ciklin bazë zhvillohet në 5 paradreke në të ashtuquajturat kohët bllok, p.sh. nga ora 8 deri në 11:30. Ndërmjet është një pushim prej rreth 30 minutash.

Kalimi në shkollën fillore

Prindërit dhe mësuesi kujdestar vendosin së bashku mbi kalimin nga kopështi ose cikli bazë në shkollën fillore.

Shkolla fillore

Shkolla fillore zgjatë 6 vjet. Pas kopështit fëmijët hyjnë në klasën e 1., ndërsa pas ciklit bazë hyjnë në klasën e 3. Gjatë pesë paradrekeve mësimi zhvillohet në kohë bllok. Në klasën e 5. fillon procedura e kalimit në ciklin sekondar I. Para se të fillojë procedura e kalimit, prindërit informohen nga ana e mësuesit kujdestar.

Procedura e kalimit

Në procedurën e kalimit zhvillohet një seleksionim. Sipas mundësisë së fëmijës për rezultate, mësuesi kujdestar dhe prindërit zgjedhin ofertën e shkollës, të cilën do të ndjekë fëmija pas klasës së 6. Kjo ofertë është ose shkolla sekondare me nivelin A deri në nivelin C ose gjimnazi kohëgjatë.

Shkolla sekondare

Shkolla sekondare zgjatë 3 vjet. Me anë të procedurës së kalimit fëmija caktohet në një nivel rezultatesh:

- Niveli A, për kërkesa më të larta
- Niveli B, për kërkesa të zgjeruara
- Niveli C, për kërkesa themelore

Në varësi të rezultateve fëmija mund ta ndërrojë nivelin.

Në shkollë sekondare të rinjtë shqyrtojnë mundësitë e tyre profesionale. Ato përkrahen në zgjedhjen e profesionit. Ata vendosin për një mësim profesioni, për një shkollë të mesme të profilizuar ose ata hyjnë në gjimnazin kohëshkurtër.

2. Vlerësimi

Kopësht, Cikli bazë, Klasa 1./2.

Fëmijët vlerësohen sipas konceptit „Vlerësim dhe nxitje në tërësi” (GBF). Këtu bëjnë pjesë bisedat e vlerësimit të detyrueshme. Në bisedë marrin pjesë mësuesi, prindërit (nëna dhe babai) dhe fëmija.

Klasa 3. – 9.

Që nga klasa e 3. jepen nota. Bisedat ndërmjet mësuesit, prindërve dhe fëmijës zhvillohen si më përpara, së paku një herë në vit.

3. Oferta nxitëse

Oferta nxitëse integruese

Nxitja integruese është një përkrahje për të gjithë klasën. Nganjëherë fëmijët ose të rinjtë kanë nevoja të veçanta. Në këto raste ata përkrahen në mënyrë të veçantë. Për ata ka oferta nxitëse në rastet e:

- vështirësive në të mësuar dhe rezultateve pjesërisht të dobëta
- talenteve të veçanta
- sfondit me gjuhë të huaj
- vështirësive në sjellje

Meqenëse nxitja ndodh brenda klasës, flitet për nxitje integruese(IF).

Mbi „Nxitjen integruese“ gjenden informacione për prindër në gjuhë të ndryshme: https://volksschulbildung.lu.ch/if_eltern

Gjermanisht si gjuhë e dytë (DaZ)

DaZ është shkurtime për „Gjermanisht si gjuhë e dytë“. Në rast se fëmijët dhe të rinjtë nuk dinë akoma mirë gjermanisht, ata përfitojnë mësimin-DaZ. Mësimi-DaZ zhvillohet në formën e mësimit për një person ose për një grup ose përmes nxitjes së integruar brenda klasës. Drejtoria e shkollës bën caktimin e fëmijëve për këtë mësim.

Shërbimet shkollore

Shërbimet shkollore përkrahin fëmijët dhe të rinjtë dhe prindërit, në rast se ata kanë vështirësi. Përkrahja është falas.

Përgjegjësitë përkatëse:

- Shërbimi i psikologjisë shkollore: Në rastet e vështirësive në të mësuar dhe në sjellje
- Shërbimi i logopedisë: Në rast të çrregullimeve gjuhësore dhe në të folur
- Qendra e terapisë psikomotorike: Në rast të anomalive në lëvizjet e imëta dhe të mëdha
- Puna sociale e shkollës: Për këshillim në çështjet sociale dhe edukative.

Për secilin shërbim shkollor në veçanti gjenden informacione për prindër në gjuhë të ndryshme.

https://volksschulbildung.lu.ch/schuldienste_eltern

Shkollim i veçantë

Fëmijët dhe të rinjtë mundet që për arsye të një kufizimi mendor, fizik, gjuhësor, kufizim në të dëgjuar, në të shikuar ose në sjellje të jenë aq të ndikuar, sa që ata kanë nevojë për një shkollim të veçantë. Në këtë rast ata kontrollohen nga specialistët:

- tek Shërbimi i psikologjisë shkollore ose
- tek Shërbimi i specializuar për sqarimet e shkollimit të veçantë pranë Qendrës së shërbimit për arsimin popullor.

Ekziston, sipas specialistëve, nevoja për një shkollim të veçantë, atëherë këto fëmijë dhe të rinjtë futen në shkollën e rregullt me mësim integruar ose ndjekin një shkollë të veçantë. Mbi shkollimin e veçantë vendos Qendra e shërbimit për arsimin popullor.

4. Oferta me pjesëmarrje vullnetare

Kurse në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK)

Kurset në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK) janë për fëmijët dhe të rinjtë me dy dhe më shumë gjuhë.

Qëllimet janë:

- Të zgjerohen shprehitë në gjuhën amtare
- Te merren njohuri mbi kulturën e atdheut, p.sh. mbi historinë, gjeografinë, festat, muzikën dhe tradicionin.

Kurset-HSK organizohen dhe zhvillohen nga përfaqësitë konsullore ose sponsorë privatë. Lajmërimi për regjistrim në këto kurse bëhet direkt tek përgjegjësit përkatës të HSK sipas grupit gjuhësor. Kurset ndiqen në mënyrë vullnetare.

Informacione për prindër mbi HSK si edhe formularët e regjistrimit janë në internet:

www.volksschulbildung.lu.ch_HSK

Përkujdesja

Shkollat ofrojnë mundësi të ndryshme të përkujdesjes jashtë orarit të shkollës. Nëse prindërit e dëshirojnë këtë, fëmijët mundën përkrah mësimin të jenë nën përkudësje në shkollë nga ora 7, gjatë drekës dhe pasdreke deri në orën 18. Prindërit duhet të paguajnë për këtë sipas të ardhurave. Informacione më të hollësishme jep drejtoria e shkollës.

Shkollat e muzikës

Komunat kanë një shkollë të muzikës me ofertat që vijnë:

- Muzikë & lëvizje (shkollë për edukimin bazë muzikor)
- Mësim instrumenti dhe këngë
- Ansamble dhe kore

Për shkollën e muzikës prindërit paguajnë kontribute. Lajmërimi për regjistrim bëhet direkt në drejtoritë e shkollave të muzikës në komuna.

5. Pushimet

Pushimet shkollore

Për një vit shkollor nxënëset dhe nxënësit kanë gjithsejt 14 javë pushim.

- Vjeshtë: dy ose tri javë
- Krishtlindjet: dy javë
- Koha e karnivaleve: dy javë njëra pas tjetrës ose të ndara në një javë pushime të karnivaleve dhe një javë pushime të sportit
- Pushimet e pranverës: dy javë
- Vera: pesë ose gjashtë javë

Datat e sakta i caktojnë komunat. Për planin e pushimeve të komunave:

https://volksschulbildung.lu.ch/schulferien_extern

Ditë të lira

Ditët mbas të dy festave „Auffahrt“ dhe „Fronleichnam“ janë të lira nga mësimi.

Leje për ditë të lira

Për ditë të lira përveç pushimeve dhe ditëve të lira zyrtare prindërit duhet të bëjnë një kërkesë: për deri në tri ditë tek mësuesi, për më shumë se tri ditë tek drejtorja e shkollës.

6. Të drejta dhe detyra të prindërve

Mësimi në shkollën popullore në shkollat e hapura është falas.

Ndjekja e shkollës është e detyrueshme për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Prindërit mbajnë përgjegjësinë për ndjekjen e shkollës. Ata kujdesen, që fëmija i tyre të shkojë në shkollë i çlodhur dhe i ushqyer. Prindërit bashkëpunojnë me mësuesit dhe drejtorinë e shkollës.

Bisedat e vlerësimit

Së paku një herë në vit mësuesi i fton prindërit dhe fëmijën në një bisedë vlerësimi. Mësuesi sqaron rezultatet e fëmijës. Fëmija tregon nga punët që ka bërë vetë dhe prindërit tregojnë nga vëzhgimet e tyre. Pjesëmarrja në bisedën e vlerësimit është e detyrueshme.

Aktivitetet shkollore

Ekskursionet, udhëtimet shkollore, ditët e sportit, kampingu me klasën, javët e projekteve e kështu me radhë janë aktivitete shkollore të detyrueshme. Prindërit informohen nga mësuesit kohë më përpara.

Detyrat e shtëpisë

Fëmijëve iu jepen detyra shtëpie, të cilat ata mund t'i zgjidhin vetë. Fëmijët i ndihmon fakti, në rast se prindërit interesohen për detyrat e shtëpisë dhe krijojnë kështu një ide, se çfarë mësojnë fëmijët. Në rast

se fëmijët vizitojnë pas shkollës një ofertë përkujdesjeje, ata shoqërohen atje gjatë zgjidhjes së detyrave të shtëpisë.

Rruga për në shkollë

Rruga për në shkollë është segmenti rrugor nga shtëpia deri në shkollë. Prindërit janë ata që mbikqyrin dhe mbajnë përgjegjësinë. Ata vendosin, se si do ta bëjë fëmija i tyre rrugën: në këmbë, me biçikletë, me autobus. Prindërit janë gjithashtu përgjegjës për rrugën që bëjnë fëmijët për në ofertat me pjesëmarrje vullnetare jashtë mësimit.

Mësimi fetar

Mësimi në shkollën popullore të hapur është nga ana fetare neutral. Prindërit vendosin, nëse fëmijët e tyre do të marrin pjesë në mësimin fetar të religjionit. Ky mësim jepet nga fetarë. Që nga ditëlindja e 16. të rinjtë mund të vendosin vetë, nëse ata dëshirojnë ta ndjekin mësimin fetar.

7. Informacione të tjera për prindër

Faqja e internetit

Informacione për prindër në gjermanisht
<https://volksschulbildung.lu.ch/system>

Dokumente për prindër të përkthyer, pamje e përgjithshme
https://volksschulbildung.lu.ch/uebersetzungen_eltern

Persona kontaktimi për prindër

Persona kontaktimi për prindërit janë mësuesit kujdestarë dhe drejtorja e shkollës.

FABIA

Qendra e specializuar për këshillimin dhe integrimin e të ardhurve (FABIA) është një qendër e specializuar e pavarur. Kjo qendër është falas në dispozicion të prindërve me gjuhë të huaj në rastet e pyetjeve, vështirësive dhe konflikteve.
www.fabialuzern.ch